

NJOFTIM

Për përfituesit/ institucionet financiare për garancinë bankare/policë sigurimi Pagesat Pjesore 60% e ndihmës publike (Grant).

Ju informojmë se bazuar në Marrëveshjen Sektoriale, e ndryshuar të ratifikuar, është aprovuar për zbatimin e Programit IPARD II 2014- 2020, procedura për pagesat pjesore, e cila do të zbatohet për të gjitha kontrata e lidhura nën IPARD II që konsistojnë në investime të ndërtimit dhe rikonstruksionit, që nuk kanë marrë një pagesë finale dhe kontratat që do të lidhen në vijim nën IPARD II.

Pagesa pjesore e përfituesit cilësohet nga autoriteti kontraktues si shpenzim i pranueshëm, kur është realizuar min. 60% e investimit lidhur me projektin që përmban punime ndërtimi/rikonstruksioni, e cila do të nënshtrohet vendosjes së një garancie bankare ose ekuivalente me të.

Afati i vlefshmërisë së garancisë bankare është 6 muaj nga përfundimi i afatit të zbatimit të investimit sipas Kontratave individuale me përfituesit.

Garancia e paraqitur do të kontrollohet për vlefshmërinë nga Agjencia IPARD me kërkesë të thjeshtë për institucionet që lëshojnë dokumentin.

Në rast se subjekti ka përfituar nga pagesa paraprake, në llogaritjen e pagesës pjesore vlera e marrë me pagesë paraprake do të zbritet.

Kjo procedurë do jetë e aplikueshme vetëm për përfituesit që janë kontraktuar dhe nuk kanë marrë një pagesë finale, të cilët do të ftohen për kryerjen e amendimit të kontratave si dhe aplikantët që do të kontraktohen në vijim nën IPARD II.

Dokumentat që praqiten pranë AZHBR janë:

- Kërkesë me shkrim për pagesën pjesore sipas formatit të ngarkuar në faqen zyrtare të AZHBR-së;
 - Faturat Originale për shpenzimet e ndodhura
 - Situacionet përkatëse për realizimin e punimeve
 - Libreza e masave
 - Garancia bankare ose garancia e sigurimit të Kontratës ;
 - Dokument identifikimi, i vlefshëm;
 - Numri i Llogarisë bankare (IBAN) sipas Kontratës;
- Në rast se ka ndryshim të të dhënave bankare apo informacione të përfituesit duhet të bëhet njoftim me shkrim për Autoritetin Kontraktor, AZHBR.

**<AGJENCIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Rruga Muhamet Gjollështa Nr.56
1001 Tiranë, Shqipëri>**